



REPubLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E DREJTËSISË  
MINISTRI

Nr. 990/Prot.  
19

Tiranë, më 6/05/2022.

URDHËR

Nr. 213 datë 16/05/2022

**“PËR DHËNIEN E MASËS DISIPLINORE GJOBË NË MASËN 300 000 LEKË DHE  
KRYERJEN E TRAJNIMIT VAZHÐUES SHITESË NË LIDHJE ME ÇËSHTJET E  
ETIKËS PROFESIONALE, PËR NOTEREN [REDAKTUAR]”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 6 dhe 7, të Ligjit Nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, të gërmës “c” dhe “ç”, të pikës 2, pikës 4, si dhe pikës 5, të nenit 26, të Ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë” dhe gërmës b) të nenit 25 të Kodit të Etikës Profesionale të Noterit, miratuar me Urdhër nr. 444, datë 30.09.2019 nga Ministri i Drejtësisë,

**KONSTATOJ:**

Në zbatim të Urdhërit të Ministrit të Drejtësisë nr. 65, datë 16.02.2022, “Për fillimin e hetimit disiplinor pranë noteres [REDAKTUAR]”, grupi i hetimit i përbërë nga nëpunësit e Ministrisë së Drejtësisë, më datë 22.02.2022 dhe 23.02.2022, ushtroi kontroll pranë zyrës së noteres [REDAKTUAR] me adresë sipas të dhënave të QKB-së, Rr: “Sulejman Delvina”, pallati “Fati”, Kati I, Tiranë.

Kontrolli u ushtrua në përputhje me nenin 30 të Ligjit nr. 110/2018 “Për Noterinë”, i ndryshuar, si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore që rregullojnë ushtrimin e veprimtarisë së noterëve.

Inspektimi ndaj noteres [REDAKTUAR] ka nisur në bazë të informacioneve të përfituara nga media audiovizive TV Klan, “Emisioni Stop”, të cilat kanë shërbyer si indicie për fillimin e hetimit kryesisht.

Pjesë e këtij hetimi disiplinor në zbatim të këtij Urdhëri, janë:

Aktet noteriale që janë administruar lidhur me pretendimet e ankueses, bashkëjetueses së shtetasit Arian Voci, konkretisht: Dëshmi Trashëgimie ligjore nr. 4117 Rep., nr. 1492 Kol, datë 27.08.2019; Kontratë Dhurimi nr. 6022 Rep nr. 22240 Kol, datë 30.12.2019; Kontratë shitje pasuri e paluajtshme e llojit automjet nr. 21 Rep., d nr. 11 Kol, datë 06.01.2021; Prokurë e posaçme nr. 1096 Rep., nr. 381 Kol, datë 18.03.2021; Kontratë shitje pasuri e paluajtshme me kusht kreditimi nr. 11118 Rep., nr. 390 Kol, datë 19.03.2021; Prokurë e posaçme nr. 1134 Rep., nr. 399 Kol, datë 20.03.2021; Deklaratë për fshirje hipoteke nr. 1633 Rep., nr. 543 Kol, datë 15.04.2021.

Aktet noteriale që janë administruar lidhur me pretendimet e ankueses Arta Gjika, konkretisht: Vendim për lëshimin e Dëshmisë së Trashëgimisë Testamentare me nr. 5841 rep., nr. 1664 kol., datë 20.11.2014; Procesverbal çelje testamenti nr. 4148 Rep., nr. 1080 Kol, datë 08.08.2014; Testamenti 194 Regj, datë 08.12.2013.

Veprimet e kryera në raport me Kodin e Etikës ndaj gazetarit [REDAKTUAR] dhe operatorit [REDAKTUAR]

Lidhur me ankesën e bashkëjetueses së shtetasit [REDAKTUAR], në redaktimin e këtij akti, noteria ka përmbushur kërkesat e Ligjit nr. 110/2018 "Për noterinë", i ndryshuar, Ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", të ndryshuar, si dhe të Kodit Civil.

Nuk ka asnjë burim provues ligjor, lidhur me pretendimet e paraqitura nga ankuesja për subjektivitet nga ana e noteres në hartimin e këtij akti. Gjithashtu, evidentohet se akteve i janë bashkëlidhur të gjitha dokumentet dhe rezulton se janë kryer verifikimet sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Lidhur me aktet noteriale që janë administruar në bazë të pretendimeve të ankueses [REDAKTUAR], sqarohet se, referuar Ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", Ministri i Drejtësisë është përgjegjës për hetimin e shkeljeve disiplinore nga noteri, deri në momentin që nuk kanë kaluar 5 vjet nga koha kur ka ndodhur shkelja, çka do të thotë se me kalimin e 5 vjetëve nga momenti kur ka ndodhur shkelja, kjo shkelje disiplinore parashkruhet dhe nuk mund të bëhet objekt verifikimi nga ana jonë. Konkretisht, neni 26, pika "6" i ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë" parashikon se "Shkeljet disiplinore parashkruhen brenda pesë vjetëve nga koha kur ka ndodhur shkelja".

Aktet noteriale, Vendim për lëshimin e Dëshmisë së Trashëgimisë Testamentare me nr. 5841 rep., nr. 1664 kol., datë 20.11.2014; Procesverbal çelje testamenti nr. 4148 Rep., nr. 1080 Kol, datë 08.08.2014; dhe Testament 194 Regj, datë 08.12.2013, nuk mund të bëhen objekt shqyrtimi nga ana jonë, pasi kanë kaluar më shumë se 5 vjet nga koha e hartimit të këtyre akteve edhe në eventualitetin kur do të konstatohej shkelje disiplinore nga ana e noterit lidhur me hartimin e tyre.

Sa i përket veprimeve të kryera ndaj gazetarit [REDAKTUAR] dhe operatorit [REDAKTUAR], noteria shfaqet me një sjellje aspak etike për profesion që ajo mban, ku me veprimet e saj arrin deri në goditje ndaj gazetarit dhe operatorit, veprime këto të cilat sjellin mos besueshmëri ndaj figurës së saj si noteri, si dhe cënojnë rëndë besimin e publikut në sistemin noterial. Veprimet e kryera ndaj gazetarit [REDAKTUAR] dhe operatorit [REDAKTUAR] provohen me pamje filmike si dhe pranohen nga vetë noteria në seancën dëgjimore audio, mbajtur nga grupi i inspektimit në datë 23.02.2022.

Në këto kushte, noteria gjendet përpara kryerjes së shkeljes disiplinore referuar pikës 1/b të nenit 26 të Ligjit nr. 110/2018 "Për noterinë" ku sanksionohet se, "1. Noteri kryen një shkelje disiplinore në rastet kur: ... b) kryen veprime ose mosveprime që janë në kundërshtim me Kodin e Etikës Profesionale dhe që cënojnë rëndë besimin e publikut në sistemin noterial;"

Në nenin 25 të Kodit të Etikës Profesionale të Noterit, miratuar me Urdhër nr. 444, datë 30.09.2019 nga Ministri i Drejtësisë, sanksionohet se "Parashikohen si shkelje të lehta, të cilat sanksionohen me gjobë, detyrimin e kryerjes së trajnimeve në lidhje me çështjet e etikës profesionale ose detyrimin e plotësimit të trajnimeve të formimit vazhdues profesional, shkeljet e mëposhtme: ... b) sjellja joetike e një noteri kundrejt institucioneve publike ose private, sipas nenit 22 të këtij Kodi;"

Ndërkohë, në nenin 22, të këtij Kodi sanksionohet se "1. Noteri, pa cenuar detyrën e tij të ruajtjes së fshehtësisë profesionale, bashkëpunon me institucionet dhe agjencitë shtetërore për funksionet e deleguara dhe, në kuadër të kornizës së marrëdhënieve zyrtare të lidhura me fushëveprimin e tij. 2. Noteri bashkëpunon me institucionet dhe agjencitë e tjera publike dhe private, kur një gjë e tillë është pjesë e ushtrimit të autoritetit publik, në pajtim me detyrat e lidhura me funksionin e tij dhe duke u siguruar se edhe ata, me të cilët bashkëpunon, janë në pajtim me këto detyra. 3. Noteri duhet të reflektojë një sjellje etike profesionale gjatë komunikimeve me institucionet publike ose private ose përfaqësuesit e tyre."

## PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 6 dhe 7, të Ligjit Nr. 8678, datë 14.05.2001 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë"; i ndryshuar, të gërme "c" dhe "ç", të pikës 2, pikës 4, si dhe pikës 5, të nenit 26, të Ligjit nr. 110/2018 "Për noterinë" dhe gërme b) të nenit 25 të Kodit të Etikës Profesionale të Noterit, miratuar me Urdhër nr. 444, datë 30.09.2019 nga Ministri i Drejtësisë, dhe gërme b) të nenit 25 të Kodit të Etikës Profesionale të Noterit, miratuar me Urdhër nr. 444, datë 30.09.2019 nga Ministri i Drejtësisë,

## URDHËROJ:

1. Dhënen e masës disiplinore gjome në masën 300 000 lekë dhe kryerjen e trajnimit vazhdues në lidhje me çështjet e etikës profesionale, noteret [redacted] anëtare e Degës Vendore të Noterisë Tiranë.
2. Noteria [redacted] të marrë të gjitha masat për përbushjen e detyrimeve të parashikuara në legjislacionin në fuqi, që lidhen me ushtrimin e rregullt të veprimtarisë noteriale, sipas parashikimeve të Ligjit 110/2018 "Për noterinë" dhe akteve nënligjore në fuqi.
3. Ky Urdhër t'i njoftohet menjëherë noteret [redacted] Degës Vendore të Noterisë Tiranë, Dhomës Kombëtare të Noterisë, si dhe medias audiovizive TV Klan, "Emisionit Stop".
4. Ndaj këtij urdhri, noteria mund të bëjë ankim në Gjykatën Administrative brenda 45 ditëve nga data e njoftimit të tij.
5. Ky urdhër, së bashku me të dhënat përkatëse, të regjistrohen në Regjistrin e Noterëve në Ministrinë e Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Noterisë, pas kalimit të afatit të ankimit.
6. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve Rregullatore të Drejtësisë pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe Dhoma Kombëtare e Noterisë, të marrin masat e nevojshme për zbatimin e këtij Urdhri.
7. Ngarkohet Qendra Shqiptare e Trajnimit të Noterëve, për marrjen e masave dhe zhvillimin e trajnimit vazhdues shtesë për noteret [redacted].

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Ulsi Marja

